



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësia:	Mr. Prot.: 270/2018
Unit:	Prot. No.:
Jediniça:	Br. Prot.:
Nr. i faqëve:	Date: 05.07.2018
No. of pages: -02-	Date:
Br. stranic:	Datum:
	Prishtëria/s

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS (OMK)**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafët 1.12 dhe 1.13 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 22, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.13 të Statutit të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 19 qershor 2018, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E SISTEMIT TË TAKSAVE ADMINISTRATIVE

I. PËRCAKTOHET sistemi i taksave administrative për procedurat administrative që iniciohen pranë organeve të Odës së Mjekëve të Kosovës, si në vijim:

- Taksa administrative për regjistrimin e parë në regjistrin e anëtarësisë në shumë prej 5.00 (pesë) € (euro);
- Taksa administrative për parashtrim të aplikacionit për valorizim të pikëve kredituese të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në shumë prej 10.00 (dhjetë) € (euro);
- Taksa administrative për dhënie të Licencës së punës pas procesit të Rilencimit, në shumë prej 40.00 (dyzet) € (euro) për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve;
- Taksa administrative për dhënie të Licencës së punës, në shumë prej 50.00 (pesëdhjetë) € (euro) për kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve;
- Taksa administrative për lëshim të faksimilit në shumë prej 15.00 (pesëmbëdhjetë) € (euro), përjashtohen nga pagesa të anëtarësuarit deri me 1 korrik 2018;
- Taksa administrative për lëshim të certifikatës për të kaluarën etike ("Certificate of good standing") në shumë prej 5.00 (pesë) € (euro) për përdorim brenda territorit të Republikës së Kosovës.
- Taksa administrative për lëshim të certifikatës për të kaluarën etike ("Certificate of good standing") në shumë prej 30.00 (tridhjetë) € (euro) për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës;
- Taksa administrative për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj mjekëve në shumë prej 30.00 (tridhjetë) € (euro);

- II. Taska administrative për iniciimin e procedurës së valorizimit të pikëve kredituese për EVP nuk kthehet në rast të refuzimit të rilicencimit. Me rastin e dhënies së licencës, shuma e taksës së paguar për iniciim të procedurës për valorizimit të pikëve kredituese për EVP për procesin e rilicencimit do të llogaritet në totalin e taksës administrative për lëshim të licencës së punës.
- III. Taksat administrative deponohen në xhirollogarinë e OMK-së dhe me para të gatshme në pajtim me dispozitat e Rregullores për Menaxhimin e Financave të OMK-së.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative në OMK.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me datë 1 korrik 2018.

Prishtinë, 19 qershor 2018

Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci

